



Në muajin shtator të këtij viti, në Kumanovë kanë arritur përfaqësues të Akademisë diplomatike për paqe dhe prosperitet-me seli në Tiranë, që personalisht Feriz Dervishit t'i dorëzojnë mirënjohjen për paqe dhe tolerancë. Nga ana e funksionarëve amerikan pensionisti nga Kumanova është personifikuar me dy falënderime, një të nënshkruar nga Kryetari i SHBA Barak Obama, ndërsa tjetra nga përfaqësuesit zyrtar në Shtëpinë e Bardhë në Uashington

Shoqata e pensionistëve të Kumanovës ka shumë arsye për të qenë krenare me veprën dhe personalitetin e anëtarit të vet, pensionistit 66 vjeçar, biznesmenit, politikanit, këshilltarit shumëvjeçar në vetëqeverisjen lokale të Kumanovës, qytetar i vlefshëm dhe i respektuar i Komunës dhe më gjerë, Feriz Dervishi. Ai është pensionisti i vetëm nga qyteti, por edhe në vendin tonë, i cili me mundin e tij

SHP Kumanovë krenare me anëtarin e vet

Mirënjohje të shumta për Dervishin



në sferën e politikës dhe humanizmit, si dhe në zhvillimin dhe thellimin e marrëdhënieve ndëretnike në vendin tonë, gjegjësisht në ndërtimin e urave mes etniteteve, i cili është sh-

përblyer me tri mirënjohje që i ndajnë përfaqësues të lartë nga SHBA dhe Shqipëria. Në muajin shtator të këtij viti, në Kumanovë kanë arritur përfaqësues

të Misionit diplomatik për paqe dhe prosperitet-me seli në Tiranë, e që vepron në rajonin e Shqipërisë, Maqedonisë, Kosovës dhe Malit të Zi, që personalisht Feriz Dervishit t'i

dorëzojnë mirënjohjen për paqe dhe tolerancë, për uljen e tensioneve ndëretnike, për aktivitetin e tij gjatë përhapjes së demokracisë në vend, njëkohësisht duke e shpallur atë si misionar të paqes. Ky çmim u ndahet vetëm qytetarëve të cilët kanë treguar rezultate të jashtëzakonshme, para së gjithash në fushën e aktiviteteve për paqe, e cila ndarje është si rezultat i përcjelljes shumëvjeçare e hulumtimeve në politikë.

Nga ana e funksionarëve amerikan pensionisti nga Kumanova, Feriz Dervishi, është personifikuar me dy falënderime, një të nënshkruar nga Kryetari i SHBA Barak Obama, ndërsa tjetra nga përfaqësuesit zyrtar në Shtëpinë e Bardhë në Uashington. Kryesisht, falënderimet Dervishit i ndahen për arritjet dhe përkushtimet e tij në

ndërtimin e kombit me të fuqishëm paqësor përmes punës vullnetare, si dhe për angazhimin e tij dhe kontributin modest ndaj aspiratës për jetë dhe paqe shoqërore mes bashkësive etnike në vend.

Për Feriz Dervishin, çmimet speciale paraqesin nderë dhe kënaqësi të posaçme, por edhe nxitje që në të ardhmen të punojë me elan edhe më të madh për këtë fushë, të vazhdojë me politikën misionare paqësore, me punën dhe aktivitetin e tij modest në fushën e bashkëjetesës dhe tolerancës të veprorë në komunën e Kumanovës dhe jashtë saj. Këtij biznesmeni të suksesshëm dhe politikani të jashtëzakonshëm, aktivist për të drejtat e njeriut misionarit të paqes, i urojmë dhe i dëshirojmë jetë të gjatë dhe suksese dhe çmime edhe më të shumta.

SHP Tetovë

Pensionistët e Tetovës në Pogradec dhe Korçë



Dy qytetet në Shqipërinë fqinje ishin të parapara në program për vizitë, Pogradeci dhe Korça

Një grup prej 50 pensionistëve nga Tetova kanë realizuar një ekskursion dyditor, i cili, sipas rrefimeve të pjesëmarrësve, do t'u mbetet gjatë në kujtimet e tyre. Rrugës për në Shqipëri, ata thuajse dy orë janë relaksuar me bukuritë e Shën Naumit. "Unë për herë të parë marr pjesë në një ekskursion të këtillë. Çka t'ju them, me të vërtetë ishte e jashtëzakonshme. Kam dëgjuar për Shën Naumin, por tani pata rastin ta përjetoj edhe kompleksin e manastirit edhe natyrën e rrethinës", u shpreh njëri prej pensionistëve.

Pas kalimit të kufirit, kompleksi Driloni është vendi ku pjesëmarrësit në ekskursion qëndruan më gjatë. Ky kompleks është vetëm disa kilometra larg nga Pogradeci, por paraqet një prej pushimoreve më të jashtëzakonshme. Kur të vihet në kontakt me Shën Naumin, fitohet përshtypja sikur shihni dy sy-në Maqedoni dhe Shqipëri. Të dyja komplekset janë të rregulluara. Dallimi është në atë se margaritari i Maqedonisë ka kompleksin e manastirit, ndërsa ai i Shqipërisë, ka vilën e diktatorit të dikurshëm të Shqipërisë Enver Hoxha, ku jo vetëm që ka pushuar, por aty ka patur edhe takime zyrtare e me shumë krerë të shteteve. Pensionistët e Tetovës gjatë qëndrimit në Drilon, kanë patur mundësinë

dhe kanë krijuar kontakte me kolegët nga Gjermania, të cilët gjithashtu ishin në ekskursion.

Pas akomodimit në hotelin "Kalaja" dhe shëtitjes së lirë nëpër Pogradec, përshtypje dhe përjetim të posaçëm ka qenë vizita e ekspozitës së fotografive të cilat kronologjikisht kanë përshkruar qytetin prej vitit 1919 e deri sot.

Ditën e ardhshme, në Korçë, fillimisht është vizituar muzeu i shkollës së parë në gjuhën shqipe "7 Marsi", i cili është e qartë se ka ndodhur në vitin 1887. Të gjithë pensionistët, pjesëmarrës në ekskursion, maqedonas dhe shqiptarë, burra e gra, morën pjesë në lutjet e mesditës që u mbajtën në kishën qendrore ortodokse në qendër të Korçës.

SHP Çair

Ekskursion njëditor në Prizren

Pensionistët për këtë udhëtim kanë treguar interesim shumë të madh dhe me dy autobusë janë nisur herët në mëngjes në drejtim të këtij qyteti të njohur për nga kultura e pasur, tradita dhe monumentet kulturore – historike

Traditën e ekskursioneve dhe vizitave të organizuara të vendeve të rëndësishme në vendin tonë dhe jashtë vendit, këtë radhë SHP Çair e ka vazhduar me vizitë të organizuar në Prizren, në vendin fqinj të Kosovës, qytetin e vendosur në veri të rrëzës së Malit Sharr. Pensionistët për këtë udhëtim kanë treguar interesim shumë të madh dhe me dy autobusë janë nisur herët në mëngjes në drejtim të këtij qyteti të njohur për nga kultura e pasur, tradita dhe monumentet kulturore – historike. Mirë i organizuar ishte ekskursioni i pensionistëve të Çairit në përbërjen e të cilit kishte maqedonas, shqiptarë, turq, romë dhe nacionalitete të tjera.

Gjatë rrugës, derisa disa këndonin ose bisedonin, të tjerët me interesim përcillnin rrethinën, të magjepsur nga bukuria vjeshtore, nga laramania e natyrës dhe gjethet e zverdhura të druve të cilët ndriçonin në shkëlqimin e rrezeve të diellit.

Pas arritjes në Prizren, pensionistët u nisën në vizitën e qytetit i cili gllabëronte shikimet me arkitekturë karakteristike tradicionale dhe nacionale. U vizituan xhamia e Sinan Pashës dhe kisha Shën Nikolla, të cilat me ndërtimin e tyre monumental prej guri tek secili ngjallnin ndjenjën e respektit. Vizitorët i kanë vizituar dhe ishin të mahnitur nga këto dy objekte të vjetra të kultit. Disa prej tyre shëtitën edhe përreth bregut të Lumit Bistrica, i cili ndanë qytetin në dy pjesë. "Gjatë vitit i cili kalon, në shoqatë bëjmë përpjekje që të përmbushim dëshirat e anëtarëve tanë, kur bëhet fjalë për vizitë të vendeve monumentale, ku nuk kanë qenë deri tani", tha Mentor Ooku, kryetari i SHP Çair.

